



Planuar / Dorezuar Punë/Prezantuar Received / Delivered	25-05-2021	1	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br / Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHCK	2616/2021		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.261/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit Anr.2522/19 të datës 31.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë /Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.173/2019 të datës 07.03.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë fshati Brod, Komuna e Shtërpcës, kundër organit të punësimit Administratës Tatimore të Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47, 48 paragrafi 1 dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 25.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa më numër A.nr.173/2019 e datës 07.03.2019 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokoli 2230/2019 i datës 05.02.2019 i Kryeministrit të Republikës së Kosovës, për emërimin e kandidatit të suksesshëm në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi kandidatë për Drejtor të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës (me tutje ATK), me datë 07.03.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 1207/2019 të regjistruar me numër A.nr.173/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër shpalljes së konkursit të datës 26.10.2018 për pozitën e

Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së, dhe Vendimit Nr.2230/2019 të datës 05.02.2019 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, mbi emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljes esenciale të dispozitave të Ligjit për Administratën Tatimore, shkeljes esenciale të dispozitave të Ligjit për Shërbimin Civil, dhe Rregullores Nr.06/2010 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, me datë 15.03.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Financave. Këshilli me datë 07.06.2019 ka pranuar përgjigjen se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuorumit për vendosje ka udhëzuar ankuesin për ushtrimin e mjeteve juridike në gjykatë sipas dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 31.03.2021 ka nxjerr Aktgjykimin Anr.2522/19 përmes të cilit ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoje dhe të vendos për ankesën e datës 07.03.2019 të parashtruar nga ankuesi

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova: Aktgjykimin Anr.2522/19 të datës 31.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë /Departamenti për Çështje Administrative; Ankesën me numër protokolli 1207/20198 të datës 07.03.2019 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 21.01.2016; Vendimin e datës 05.02.2019; Vendimin e datës 21.01.2019; Struktura Organizative të Administratës Tatimore të Kosovës; Rekomandimin e datës 01.02.2019; Shkresën e datës 05.02.2019 të Ambasadës Britanike në Kosovë; Informatën e datë 26.10.2018; Akt Emërimit e datës 28.02.2014; Shkresën e datës 09.11.2018; E-mailin e datës 13.02.2019; E-mailin e datës 15.02.2019; E-mailin e datës 22.02.2019; Përgjigjen në ankesë të datës 07.06.2019; Provat e tjera të nxjerra nga procedura e rekrutimit të datës 19.02.2019; Aktgjykimin në rasti nr.KO171/18 i Gjykatës Kushtetuese i datës 20.05.2019; Njoftimin e datës 19.02.2019; Rekomandimin e datës 04.02.2019 nga Komisioni Vlerësues; Vendimin Nr.53/2018 të datës 13.12.2018 për formimin e komisionit vlerësues.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pa bazuar, sepse:**

Sipas shkresave të lëndës, rezulton se ankuesi përmes Vendimit Nr.003/2016 të datës 19.01.2016 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, është emëruar Drejtor i Përgjithshëm i ATK-së, me mandat prej tre (3) vite.

Ministria e Financave të Republikës së Kosovës, me datë 26.10.2018 ka shpallur konkurs publik për rekrutimin e pozitës së Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së. Pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, Kryeministri i Republikës së Kosovës, përmes Vendimit Nr.prot. 2230/2019 të datës 05.02.2019, ka emëruar Drejtor të Përgjithshëm të ATK-së, kandidatin I



Kundër këtij vendimi, ankuesi me datë 07.03.2019 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljes esenciale të dispozitave të Ligjit për Administratën Tatimore, shkeljes esenciale të dispozitave të Ligjit për Shërbimin Civil, dhe Rregullores Nr.06/2010 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me pretendimin se: Konkursi për rekrutimin e pozitës së Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së, nuk ka mundur të shpallet pa i përfunduar mandati ankuesit, kandidati i emëruar ka qenë i renditur i pesti (5) sipas vlerësimit të Kompanisë Britanike, BDO, si dhe pretendim ankimor lidhur me sistemimin e tij pas përfundimit të mandatit të Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me shpalljen e konkursit për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se pretendimi ankimor si i tillë nuk qëndron sepse me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, përkatësisht nenin 3 paragrafi 1 përcaktohet se: *ATK do të drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm që do të emërohet nga Kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës bazuar në rekomandimin e dorëzuar nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave. Rekomandime të tilla duhet të bëhen pas kompletimit të procesit të rekrutimit që inicohet nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave i kryer në pajtim me dispozitat e legjislacionit dhe rregulloreve në fuqi që lidhen me shërbimin civil të Kosovës, ndërsa me nenin 15 paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përcaktohet se: ...Për institucionet e ekzekutivit, Ministria përgjegjëse për administratë publike i propozon Qeverisë për miratim kandidatin e preferuar nga titullari i institucionit, i cili miratohet nga Qeveria në pozicionin përkatës për një mandat tre (3) vjeçar. Mbi këtë bazë ligjore, ankuesi është emëruar Drejtor i Përgjithshëm i ATK-së, me datë 19.01.2016 dhe i njëjti ka ushtruar mandatin deri me datë 18.01.2019. Andaj, duke marr parasysh se ankuesi e ka ushtruar mandatin e tij të plotë, siç përcaktohet me Vendimin Nr.003/2016 të datës 19.01.2016 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, dhe nenin 15 paragrafi 3 Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit se konkursi për Drejtor të Përgjithshëm të ATK-se është shpallur në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, është i pa bazuar.*

Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për emërimin e Drejtor të Përgjithshëm të ATK-së, sipas konkursit të datës 07.03.2019, Kolegji ka shqyrtuar shkresat e lëndës dhe si rrjedhojë ka gjetur se Komisioni Përzgjedhës i themeluar sipas Vendimit Nr.53/2018 të datës 13.12.2018, pas zhvillimit të procedurës së rekrutimit me datë 02.02.2019, përmes shkresës me numër protokolli 126 ka njoftuar Ministrin e Ministrisë së Financave, lidhur me ecurinë e procedurës së rekrutimit, dhe njëherit për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së ka rekomanduar tre (3) kandidate të suksesshëm, si në vijim: I.M 30.6 pikë, I.L 30.4 pikë, dhe

27.0 pikë. Kryeministri i Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 3 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, dhe nenin 15 të Rregullores (QRK) Nr.17/2018 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me datë 05.02.2019 ka nxjerr Vendimin me numër protokolli 2230/2019 përmes të cilit ka emëruar kandidatin I.M, Drejtor të Përgjithshëm të ATK-së, andaj duke marr parasysh se kandidati i emëruar në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së është njeri prej



tre (3) kandidateve të vlerësuar me më se shumti pikë nga Komisioni Përzgjedhës, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor në këtë kuptim është i pa qëndrueshëm.

Ankuesi, pas përfundimit të mandatit të Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së, i është drejtuar me shkrim organit të punësimit, gjegjësisht Administratës Tatimore të Kosovës, me kërkesë për sistemim në ATK, dhe meqenëse nuk ka marr përgjigje pozitive, i njëjti në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se i njihet e drejtat e ruajtjes se pozitës ekuivalente sipas dispozitave të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Përkitazi me këtë pretendim, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, përkatësisht nenin 89 ku përcaktohet se: *Pezullimi i dakorduar i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil 1. Për qëllime të këtij ligji, rastet në vijim konsiderohen pezullim i dakorduar nga shërbimi civil: 1.1. pushimi pa pagesë; 1.2. transferimi i përkohshëm në detyra të tjera brenda ose jashtë Kosovës; 1.3. marrjes së detyrës së funksionarit publik; 1.4. kryerja e obligimeve ushtarake. 2. Pas mbarimit të kushtit të pezullimit të dakorduar, nëpunësi civil ruan të drejtën e kthimit në pozitën e mëparshme ose në një pozitë ekuivalente, dhe duke marr parasysh se me këtë dispozitë ligjore nuk parashihet mundësia e pezullimit të pozitës me rastin e emërimit të nëpunësit civil në pozitë të lartë drejtuese, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit në këtë kuptim është i pa bazuar.*

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.261/2021

Zyle Millaku GOJNOVCI



Zyrtarë e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Ministrinë e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
- Drejtorin të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës; dhe
- Arkivin të KPMSHCK-së.